



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.1, 24.2 dhe 40.2 "b" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 40.2 "b" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 26.09.2013, mori këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, KAB-i dhe lista e projekteve prioritare për vitin 2014, konform Qarkores Buxhetore 2014/02 të MEF-it, dt. 16.07.2013.

### Neni 2

Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2014 është 13,419,233.00 €, prej të cilave për:

- Paga.....7,310,541.00 €.
- Mallra dhe shërbime.....1,365,862.00 €.
- Komunalitë..... 248,360.00 €.
- Subvencione.....266,375.00 €.
- Shpenzime kapitale..... 4,228,095.00 €.
- Githsejt:..... 13,419,233.00 €.**

### Neni 3

Të hyrat vetanake të planifikuara.....1,652,000.00 €.

### Neni 4

Mjetet financiare të cekura në nenin 2 dhe 3 të këtij vendimi do të sigurohen në pajtim me Qarkoren Buxhetore 2014/02 të MEF-it në bazë të kufijve të dhënë, Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe dispozitat tjera ligjore dhe aktet tjera që e rregullojnë këtë çështje.

### Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe organet tjera kompetente.

### Neni 6

Tabela 4.1- Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2014 (faqe 1-3); Tabela 4.2 – Investimet kapitale në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2014 (faqe 4-5); Lista për mjetet e subvencioneve dhe transfereve, si dhe Tabela për projektet e kanalizimeve janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

**Neni 6**

Ky vendim hyn pas aprovimit dhe nënshkimit nga kryesuesi i kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
  
**Habib Mustafa**





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br. 223 / 13

Nr. i fq. / Br. sh. -1-

Data: / Datum 26.09.2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës dhe në bazë të propozimit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 26.09.2013, mori këtë:

### V E N D I M

#### Për aprovimin e Rregullores mbi tatimin e pronës së paluajtshme

##### Neni 1

Aprovohet Rregullorja mbi tatimin në pronën e paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2014.

##### Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

##### Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 225/13

Nr. i fq. / Br. at -1-

Data: / Datum 26.09.2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 40.2 "dh" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: 26.09.2013, mori këtë:

## V E N D I M

### PËR RIDESTINIMIN DHE TRASNFERIN E MJETEVE BUXHETORE TË KOMUNËS

#### Neni 1

1.1. Me këtë vendim ridestinohen mjetet nga:

1.1.1. Fondi 21, nga kategoria e investimeve kapitale (programi 664470, Drejtoria për Bujqësi), kodi i projektit 88500, ngritja e serrave në vlerë prej 30,000.00 €, dhe nga ky projekt shuma e mjeteve të lira buxhetore 2,723.50 € ridestinohen në projektin e ri: **Pajisje e furrës me plin-gaz për shoqatën "Martirët e Lirisë" në Vushtrri.**

1.1.2. Fondi 10 Granti qeveritar mallra dhe shërbime në Drejtorinë për Shërbime Publike, shuma e mjeteve prej 2.000 € transferohen në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport (kodi i programit 644850).

1.1.3. Shuma e mjeteve prej 21,948.00 € do të bartet nga mjetet e mbetura (të lira) nga projektet që janë në finalizim, për realizimin e këtyre dy projekteve:

a. Kodi i projektit 88506 - Asfaltimi i rrugës "Ismail Qemajli", shuma e mjeteve 18,888.00 €;

b. Kodi i projektit 88514 - Asfaltimi i rrugës Bukosh-Taraxhë, shuma e mjeteve 3,060.00 €.

#### Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

#### Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa

